



Crna Gora / Mali i Zi  
Opština Ulcinj  
Komuna e Ulqinit  
Kabinet Predsjednika  
Kabineti i Kryetarit

Br./Nr. 01-68/20-2  
Ulcinj/Ulqin, 04.02.2020.god.vit



Crna Gora - Mali i Zi  
Opština Ulcinj - Komuna e Ulqinit

Priheto - Prunor	Ug-eti	Tip: Org	Braj	Humer	Prilog - Bashkan	Vijed - Vlera
01-02-2020	02		13	20-		1

**SKUPŠTINA OPŠTINE ULCINJ**  
n/r Predsjedniku

Ovdje

**Predmet:** Prijedlog „Odluke o uslovima, postupku i načinu dodjeljivanja Javnih priznanja i nagrada Opštine Ulcinj“

Prosljeđujemo Prijedlog „Odluke o uslovima, postupku i načinu dodjeljivanja Javnih priznanja i nagrada Opštine Ulcinj“ radi dostavljanja nadležnim radnim tijelima Skupštine Opštine na dalje razmatranje.

Prijedlog Odluke je pripremila Socijaldemokratska partija Crne Gore, njihov br. 06/20 od 31.01.2020. godine.

S poštovanjem!



Predsjednik  
Loro Nrekić



Ulcinj, 31.01.2020.god.  
Broj: 06/20

Crna Gora - Mali i Zi  
Opština Ulcinj - Komuna e Ulqinit

Prilijeno - Pranuor	03-02-2020		
Orgjea - Njes Oig	Broj Numer	Prilog - Bashkan	Vrijed - Viera
01+	68	20	-1

OPŠTINA ULCINJ  
PREDJEDNIK  
G-din, Ljoro Nrekić

Poštovani Predsjedniče,

Na osnovu člana 55 Poslovnika Skupštine opštine Ulcinj (Sluzbeni list CG- Opštinski propisi br.17/08 i 14/12), člana 27 i 54 Statuta Opštine Ulcinj("Službeni list CG - opštinski propisi", br. 48/19), podnosim:

- Prijedlog odluke o uslovima, postupku i načinu dodjelivanja Javnih priznanja i nagrada Opštine Ulcinj

Predlažem da se predmetni Prijedlog odluke dostavi nadležnim radnim tijelima Skupštine Opštine na dalje razmatranje i uvrsti na dnevni rad na prvoj redovnoj sjednici Skupštine u martu 2020. godine.

Prilog|: kao u tekstu

Dostavljeno|:  
Predsjedniku Skupštine Opštine Ulcinj  
Predsjedniku Opštine Ulcinj  
A/A



PODNOŠILAC PRIJEDLOGA ODLUKE

Odbornik SDP Ulcinj  
Naser Resulbegović

Na osnovu člana 38 stav 1 tačka 2 Zakona o lokalnoj samoupravi („Službeni list CG“, br. 2/18 i 34/19) i člana 27 Statuta Opštine Ulcinj ("Službeni list CG - opštinski propisi", br. 48/19), Skupština Opštine Ulcinj, na sjednici održanoj dana 2020 .godine, **donijela je**

## **ODLUKU** **o uslovima, postupku i načinu dodjeljivanja Javnih priznanja i nagrada Opštine Ulcinj**

### **I OPŠTE ODREDBE**

#### **Član 1**

Odlukom o Javnim priznanjima i nagradama Opštine Ulcinj (u daljem tekstu: Odluka) uređuju se Javna priznanja i nagrade Opštine Ulcinj, uslovi, postupak i način njihove dodjele.

#### **Član 2**

Izrazi koji se u ovoj Odluci koriste za fizička lica u muškom rodu, podrazumijevaju iste izraze u ženskom rodu.

#### **Član 3**

Opština Ulcinj dodjeljuje Javna priznanja i nagrade, radi odavanja priznanja za izuzetna dostignuća i doprinos od posebnog značaja za razvoj i ugled Opštine Ulcinj, ostvarenju i razvoju demokratije i mira u Crnoj Gori ili svijetu, a posebno za izuzetne uspjehe u unapređivanju preduzetništva, privrede, obrazovanja, umjetnosti, kulture, zaštite i unapređivanja životne sredine, sporta, zdravstva, socijalne zaštite i drugih oblika društvenog života, koje predstavlja izuzetan doprinos razvitku i ugledu Opštine Ulcinj.

### **II VRSTE JAVNIH PRIZNANJA I NAGRADA I NAČIN DODJELE**

#### **Član 4**

Javna priznanja Opštine Ulcinj su:

- a) Počasni građanin Opštine Ulcinj,
- b) Priznanje Opštine Ulcinj za životno djelo,
- c) Godisnja nagrada Opštine Ulcinj i
- d) druge nagrade.

#### **a) Zvanje „Počasni građanin Ulcinja“**

#### **Član 5**

Zvanje "Počasni građanin Ulcinja" može se izuzetno dodijeliti državljaninu Crne Gore ili stranom državljaninu koji je svojim radom, naučnim ili političkim djelovanjem, značajno doprineo napretku i unapređenju ugleda Opštine Ulcinj, i koji ima izuzetne zasluge u oblasti zaštite i unapređenja životne sredine, položaju i ugledu Ulcinja, i njegovog statusa i odnosa sa drugim gradovima u zemlji i inostranstvu.

#### **Član 6**

Zvanje "Počasni građanin Ulcinja" dodjeljuje se u vidu Povelje.

#### **Član 7**

Prijedlog za dodjelu zvanja "Počasni građanin Ulcinja" mogu podnijeti: Predsjednik Opštine, odbornik u Skupštini i najmanje 2% građana od broja upisanih u birački spisak Opštine Ulcinj sa poslednjih sprovedenih izbora.

Prijedlog se podnosi u pisanoj formi sa detaljnim obrazloženjem.

#### **Član 8**

Odluku o dodjeli zvanja "Počasni građanin Ulcinja" donosi Skupština opštine Ulcinj.

#### **Član 9**

Postupak za dodjeljivanje zvanja "Počasni građanin Ulcinja" sprovodi Komisija za dodjelu zvanja, koju imenuje Skupština Opštine iz reda istaknutih naučnih, privrednih, kulturnih i javnih radnika i NVO. Komisiju čine Predsjednik i četiri člana. Mandat Komisije traje koliko i mandat Skupštine.

#### **Član 10**

Komisija donosi Poslovnik o radu. Poslovnikom se uređuje način rada kao i druga pitanja od značaja za rad Komisije. Stručne i administrativno-tehničke poslove za potrebe Komisije vrši Sekretarijat za upravu i društvene djelatnosti Opštine Ulcinj.

#### **Član 11**

Komisija utvrđuje prijedlog Odluke o dodjeli zvanja "Počasni građanin Ulcinja" i isti uz obrazloženje dostavlja Skupštini Opštine na usvajanje. Skupština Opštine odlučuje o dodjeljivanju zvanja "Počasni građanin Ulcinja".

#### **Član 12**

Odluku i obrazloženje o dodjeljivanju zvanja "Počasni građanin Ulcinja" saopštava na sjednici Predsjednik Opštine Ulcinj, prilikom uručivanja povelje. Povelju o zvanju "Počasni građanin Ulcinja", uručuje Predsjednik Opštine.

#### **Član 13**

Povelja je pravougaonog oblika, urađena na pergamentu, ispisana kaliografski na crnogorskom, albanskom i engleskom jeziku i pismu, sa posrebrenim pločicama (alt: pozlaćene), na kojima je grb Crne Gore i grb Opštine Ulcinj.

#### **Član 14**

Povelja "Počasni građanin Ulcinja" dodjeljuje se svake četvrte godine, povodom Dana Opštine Ulcinj, na svečanoj sjednici Skupštine.

#### **Član 15**

Zvanje "Počasni građanin Ulcinja" će se oduzeti nosiocu u slučaju da bude pravosnažnom sudskom odlukom osuđen na bezuslovnu kaznu zatvora, a koje ga čini nedostojnim ovog javnog priznanja. Odluka o oduzimanju zvanja "Počasni građanin Ulcinj" donosi se po postupku utvrđenom za njegovo dodjeljivanje.

b) Priznanje Opštine Ulcinj za životno djelo

#### **Član 16**

Priznanje Opštine Ulcinj za životno djelo je javno priznanje koje se dodjeljuje fizičkom licu za cjelokupno postignuće na unapređivanju nauke, privrede, zdravstva i socijalne zaštite, sporta, umjetnosti, kulture, obrazovanja i drugih oblika društvenog života, koje predstavlja izuzetan doprinos razvitku i ugledu Opštine Ulcinj.

#### **Član 17**

Priznanje Opštine Ulcinj za životno djelo dodjeljuje se u vidu Plakete.

#### **Član 18**

Pravo na dodjeljivanje Plakete mogu ostvariti pojedinci koji žive na teritoriji Opštine Ulcinj ili van njene teritorije, ukoliko njihova ostvarenja imaju poseban značaj za Opštinu Ulcinj.

#### **Član 19**

Plaketa Opštine Ulcinj se dodjeljuje na svečanoj sjednici povodom Dana Opštine Ulcinj ili povodom raznih jubileja, obilježavanja državnih praznika i drugih manifestacija.

#### **Član 20**

Priznanje za životno djelo se istom licu može dodjeliti samo jedanput. Priznanje Opštine Ulcinj za životno djelo se može, kad za to postoje naročito opravdani razlozi, dodijeliti i posthumno.

b) Godišnja nagrada Opštine Ulcinj

#### **Član 21**

Godišnja nagrada Opštine Ulcinj se dodjeljuje domaćem ili stranom fizičkom ili pravnom licu za postignuća i doprinos u posljednje dvije godine, koji su od posebnog značaja za Opštinu Ulcinj.

#### **Član 22**

Godišnja nagrada Opštine ulcinj dodjeljuje se u vidu Zahvalnice i u novčanom iznosu koji ne može biti niži od jedne, niti veći od tri prosječne mjesečne neto zarade isplaćene u mjesecu koji prethodi mjesecu u kojem se nagrada dodjeljuje.

#### **Član 23**

Godišnja nagrada Opštine Ulcinj dodjeljuje se na svečanoj sjednici povodom Dana Opštine Ulcinj ili povodom raznih jubileja, obilježavanja državnih praznika i drugih manifestacija.

c) druge nagrade

#### **Član 24**

Nagrade definisane u članu 26 Statuta Opštine Ulcinj dodjeluju se u vidu Zahvalnica i u novčanom iznosu, i to u visini od jedne prosječne mjesečne neto zarade isplaćene u mjesecu koji prethodi mjesecu u kojem se nagrada dodjeljuje.

#### **Član 25**

Nagrade iz člana 24 ove Odluke dodjeljuje se na svečanoj sjednici povodom Dana Opštine Ulcinj ili povodom raznih jubileja, obilježavanja državnih praznika i drugih manifestacija.

### **III POSTUPAK PODNOŠENJA PRIJEDLOGA I DODJELE JAVNIH PRIZNANJA I NAGRADA**

#### **Član 26**

Postupak predlaganja, odlučivanja i dodjele Javnih priznanja i nagrada iz člana 4 stav 1 alineje b), c) i d) ove Odluke, sprovodi Žiri za dodjelu Javnih priznanja i nagrada Opštine Ulcinj (u daljem tekstu: žiri), koji objavljuje javni poziv za prikupljanje prijedloga za dodjelu Javnih priznanja i nagrada do 10. oktobra tekuće godine.

#### **Član 27**

Pravo predlaganja kandidata imaju: Predsjednik Opštine, radna tijela Skupštine, odbornik, privredna društva, nevladine organizacije, sportske i druge organizacije, mjesne zajednice, pojedinci i drugi subjekti, i to do 31. oktobra tekuće godine. Neblagovremeni prijedlozi se ne mogu razmatrati.

#### **Član 28**

Prijedlog za dodjelu Javnih priznanja i nagrada Opštine Ulcinj podnosi se u pisanom obliku. Pisani prijedlog za dodjelu Javnih priznanja i nagrada Opštine Ulcinj obavezno sadrži sledeće podatke: ime i prezime odnosno naziv podnosioca prijedloga, prebivalište ili sjedište podnosioca prijedloga, naziv javnog priznanja i nagrade i područje za koje se podnosi prijedlog, detaljno obrazloženje prijedloga odnosno postignuća i doprinosa radi kojih se predlaže dodjela javnog priznanja i nagrade Opštine Ulcinj.

#### **Član 29**

Odluku o dodjeli Javnih priznanja i nagrada donosi Žiri.

Predsjednika i članove Žirija imenuje Skupština opštine na period od dvije godine i isti mogu biti ponovo imenovani, ali ne više od dva puta uzastopno.  
Predlog za izbor članova Žirija Skupštini opštine podnosi Predsjednik Opštine.

#### **Član 30**

Žiri ima predsjednika i četiri člana.

Za članove žirija imenuju se istaknuti javni, kulturni, naučni, zdravstveni i sportski radnici.

Žiri na prvoj konstitutivnoj sjednici donosi Poslovnik o svom radu.

U slučaju prestanka mandata članu žirija, novoizabranom članu mandat traje do isteka mandata žirija.

#### **Član 31**

Žiri odlučuje na sjednicama.

O toku sjednice i glasanju vodi se zapisnik.

Žiri donosi odluke većinom glasova svih članova.

U slučaju potreba provjere i pojašnjenja podataka iz prijedloga, žiri može tražiti mišljenje od nadležnih državnih organa i organa lokalne samouprave.

U slučaju potrebe prilikom razmatranja podnesenih prijedloga, žiri se može konsultovati sa stručnjacima za pojedine oblasti.

#### **Član 32**

Odluku i obrazloženje o dodjeli javnog priznanja, odnosno nagrade saopstava na svečanoj sjednici Skupštine predsjednik Žirija, prilikom urucivanja javnog priznanja, odnosno nagrade.

Žiri neće donijeti odluku o dodjeli Javnih priznanja i nagrada ako ocijeni da predloženi kandidat ne ispunjava uslove za njeno dodjelivanje.

Javno priznanje i nagradu potpisuju Predsjednik Opštine i predsjednik Skupštine Opštine Ulcinj.

#### **Član 33**

Žiri ima pravo na naknadu za rad.

Visinu naknade iz stava 1 ovoga člana utvrđuje Predsjednik Opštine Ulcinj.

### **IV PRELAZNE I ZAVRŠNE ODREDBE**

#### **Član 34**

Stručne i administrativne poslove, kao i evidenciju o Javnim priznanjima i nagradama obavlja Služba Sekretarijata za upravu i društvene djelatnosti.

#### **Član 35**

Ova odluka stupa na snagu osmog dana od dana objavljivanja u "Službenom listu CG - opštinski propisi".

Broj:  
Ulcinj, \_\_\_\_\_ 2020.godine

**SKUPŠTINA OPŠTINE ULCINJ**

**PREDSJEDNIK SKUPŠTINE,**  
Dr Ilir Capuni, s.r.

## **OBRAZLOZENJE**

### **I Pravni osnov za donosenje odluke**

Pravni osnov za donosenje ove odluke sadržan je u odredbama člana 38 stav 1 tačka 2 Zakona o lokalnoj samoupravi („Službeni list CG“, br. 2/18 i 34/19) i člana 27 Statuta Opštine Ulcinj („Službeni list CG - opštinski propisi“, br. /19), kojima je propisano da Skupština donosi propise i druge opšte akte, kao i da se uslovi, postupak, način dodjelivanja javnih priznanja i nagrada kao i druga pitanja, uređuju se posebnom odlukom Skupštine opštine.

### **II Razlozi za donosenje odluke**

Predlog ove odluke pripremljen je kako bi stvorile pravne pretpostavke za dodjelivanje Javnih priznanja i nagrada Opštine Ulcinj koje su ustanovljene Statutom Opštine Ulcinj, i time blize definisali uslovi, postupak i način dodjela priznanja i nagrada.

### **III Objasnjenje osnovnih pravnih instituta**

Ovom odlukom propisuju se predmet uredjenja odluke (clan 1), određuju se lica kojima se dodjeljuje ovo javno priznanje (clan 3), određuju se vrste i način dodjele javnih priznanja i nagrada (cl. 4 do cl.9) propisuje postupak za dodjelu javnog priznanja (cl.9 do cl.13), oblik i sadržina Povelje i način njenog urucenja (cl. 9 do cl.13), oduzimanje dodjeljenog javnog priznanja (clan 15), propisuju se uslovi i određuju se lica koja mogu ostvariti pravo na dodjelivanje javnih priznanja i nagrada iz clana 4 stav 1 alineje b), c) i d) (cl.16 do cl. 25) kao i postupak podnosenja prijedloga i dodjele Javnih priznanja i nagrada (cl.26 do cl.33). U prelaznim i završnim odredbama definisan je organ za obavljanje stručnih i administrativnih poslova za potrebe žirija (clan 34) i propisuje vrijeme stupanja na snagu – vocacio legis, ove odluke (clan 35).

### **IV Sredstva potrebna za sprovođenje odluke**

Za sprovođenje ove odluke potrebno je obezbjediti sredstva u Budžetu Opštine Ulcinj.

Në bazë të nenit 38, paragrafi 1, pika 2 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale ("Fletorja zyrtare e MZ", nr. 2/18 dhe 34/19) dhe nenit 27 të Statutit të Komunës së Ulqinit ("Fletorja zyrtare e MZ – dispozitat e komunës", nr. 48/19), Kuvendi i Komunës së Ulqinit, në mbledhjen e mbajtur, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2020 ka nxjerrë

**VENDIMIN**  
**për kushtet, procedurën dhe mënyrën e ndarjes së mirënjohjeve dhe çmimeve publike të Komunës së Ulqinit**

**I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

**Neni 1**

Me Vendimin për mirënjohjet dhe çmimet publike të Komunës së Ulqinit (në vazhdim: Vendimi) rregullohen mirënjohjet dhe çmimet publike të Komunës së Ulqinit, kushtet, procedura dhe mënyra e ndarjes së tyre.

**Neni 2**

Termet të cilët në këtë Vendim përdoren për personat fizikë në gjininë mashkullore, nënkuptojnë po ato terma në gjininë femërore.

**Neni 3**

Komuna e Ulqinit ndan Mirënjohje dhe çmime publike, me qëllim të njohur arritjet dhe kontributin e jashtëzakonshëm me rëndësi të veçantë për zhvillimin dhe reputacionin e Komunës së Ulqinit, realizimin dhe zhvillimin e demokracisë dhe qetësisë në Mal të Zi apo në botë, e veçmas për sukseset e jashtëzakonshme në avancimin e sipërmarrsisë, ekonomisë, arsimit, artit, kulturës, mbrojtjen dhe avancimin e mjedisit, sportit, shëndetësisë, mbrojtjes shëndetësore dhe format e tjera të jetës shoqërore, që janë një kontribut i jashtëzakonshëm për zhvillimin dhe reputacionin e Komunës së Ulqinit.

**II LLOJET E MIRËNJOHJEVE DHE ÇMIMEVE PUBLIKE DHE MËNYRA E NDARJES**

**Neni 4**

Mirënjohjet publike dhe çmimet e Komunës së Ulqinit janë:

- a) Qytetar nderi i Komunës së Ulqinit,
- b) Mirënjohja e Komunës së Ulqinit për veprën jetësore,
- c) Çmimi vjetor i Komunës së Ulqinit dhe
- d) çmime të tjera.

- a) Titulli "Qytetar nderi i Ulqinit"

**Neni 5**

Titulli "Qytetar nderi i Ulqinit" mund të ndahet vetëm nënshetësit të Malit të Zi ose shtetasit të huaj i cili me punën e tij, shkencore ose me veprimtarinë politike, në mënyrë të dukshme ka kontribuar në përparimin dhe avancimin e reputacionit të Komunës së Ulqinit, dhe i cili ka merita të jashtëzakonshme në fushën e mbrojtjes dhe avancimit të mjedisit, pozitës dhe reputacionin e Ulqinit dhe statusin e tij në raport me qytetet e tjerë në vend dhe jasht tij.

**Neni 6**

Titulli "Qytetar nderi i Ulqinit" ndahet në formë të Diplomës.

**Neni 7**

Propozimin për ndarjen e titullit "Qytetar nderi i Ulqinit" mund ta parashtrojnë: Kryetari i Komunës, këshilltari në Kuvend dhe së paku 2 % e qytetarëve nga numri i regjistruar në listën zgjedhore të Komunës së Ulqinit nga zgjedhjet e fundit të mbajtura.

Propozimi parashtrohet me shkrim me arsyetim të hollësishëm.

**Neni 8**

Vendimin për ndarjen e titullit "Qytetar nderi i Ulqinit" e nxjerr Kuvendi i Komunës së Ulqinit.



#### **Neni 9**

Procedurën për ndarjen e titullit "Qytetar nderi i Ulqinit" e zbaton Komisioni për ndarjen e titujve, të cilin e emëron Kuvendi i Komunës nga radhët e punëtorëve të dalluar nga fusha e shkencës, ekonomisë, kulturës dhe publikë dhe OJQ.

Komisionin e përbëjnë Kryetari dhe katër anëtarë.

Mandati i Komisionit zgjatën sa edhe mandati i Kuvendit.

#### **Neni 10**

Komisioni nxjerr Rregulloren e punës.

Me Rregullore rregullohet mënyra e punës si dhe çështje të tjera me rëndësi për punën e Komisionit.

Punët profesionale dhe administrative – teknike për punën e Komisionit i kryen Sekretariati për administratë dhe veprimtari shoqërore i Komunës së Ulqinit.

#### **Neni 11**

Komisioni konfirmon propozim Vendimin për ndarjen e titullit "Qytetar nderi i Ulqinit" dhe atë me arsyetim ia dorëzon Kuvendit për miratim.

Kuvendi i Komunës vendosën për ndarjen e titullit "Qytetar nderi i Ulqinit".

#### **Neni 12**

Vendimin dhe arsyetimin për ndarjen e titullit "Qytetar nderi i Ulqinit" e komunikon në mbledhje Kryetari i Komunës së Ulqinit, me rastin e dorëzimit të diplomës.

Diplomën për titullin "Qytetar nderi i Ulqinit" e dorëzon Kryetari i Komunës.

#### **Neni 13**

Diploma ka formë katërkëndëshe, e punuar në pergamenë, kaligrafisht e shkruar në gjuhën dhe shkrimin malazez, shqip dhe anglisht, me pllakëza argjendi (alt: praruara), në të cilat është stema e Malit të Zi dhe stema e Komunës së Ulqinit.

#### **Neni 14**

Diploma "Qytetar nderi i Ulqinit" ndahet çdo të katërtin vit, me rastin e Ditës së Komunës së Ulqinit, në mbledhjen solemne të Kuvendit.

#### **Neni 15**

Titulli "Qytetar nderi i Ulqinit" do t'i merret bartësit në rastin kur është i dënuar me akt gjykim të formës së prerë me dënim të pakushtëzuar me burgim, e cila e bënë të padenjë për këtë mirënjohje publike.

Vendimi për marrjen e titullit "Qytetar nderi i Ulqinit" nxirret sipas procedurës së konfirmuar për ndarjen e tij.

b) Mirënjohja e Komunës së Ulqinit për veprën jetësore

#### **Neni 16**

Mirënjohja e Komunës së Ulqinit për veprën jetësore është mirënjohje publike e cila i ndahet personit fizik për të arriturat e përgjithshme për avancimin e shkencës, ekonomisë, shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale, sportit, artit, kulturës, arsimit dhe formave të tjera të jetës shoqërore, të cilat paraqesin një kontribut të jashtëzakonshëm për zhvillimin dhe reputacionin e Komunës së Ulqinit.

#### **Neni 17**

Mirënjohja e Komunës së Ulqinit për veprën jetësore ndahet në formë të pllakës.

#### **Neni 18**

Të drejtën për ndarjen e Pllakës mund ta realizojnë individët të cilët jetojnë në territorin e Komunës së Ulqinit apo jashtë territorit të saj, nëse arrijtjet e tyre kanë një rëndësi të posaçme për Komunën e Ulqinit.

#### Neni 19

Pllaka e Komunës së Ulqinit ndahet në mbledhjen solemne me rastin e Ditës së Komunës së Ulqinit ose me rastin e përvjetorëve të ndryshëm, shënimit të festave shtetërore dhe manifestimeve të tjera.

#### Neni 20

Mirënjohja për veprën jetësore të njëjtit person mund t'i ndahet vetëm një herë.  
Mirënjohja e Komunës së Ulqinit për veprën jetësore, kur ekzistojnë shkaqe të arsyeshme, mund të ndahet edhe pas vdekjes.

c) Çmimi vjetor i Komunës së Ulqinit

#### Neni 21

Çmimi vjetor i Komunës së Ulqinit i ndahet një personi të vendit apo të huaj fizik apo juridik për arritjet dhe kontribut në dy vitet e fundit, që janë të një rëndësie të veçantë për Komunën e Ulqinit.

#### Neni 22

Çmimi vjetor i Komunës së Ulqinit ndahet në formë të Fletëfalënderimit dhe në një shumë monetare që nuk mund të jetë më e vogël se një, e as më e madhe se tri rroga neto mujore të paguara në muajin i cili i paraprinë muajit në të cilin ndahet çmimi.

#### Neni 23

Çmimi vjetor i Komunës së Ulqinit ndahet në mbledhjen solemne me rastin e Ditës së Komunës së Ulqinit ose me rastin përvjetorëve të ndryshëm, shënimit të festave shtetërore dhe manifestimeve të tjera.

ç) çmimet e tjerë

#### Neni 24

Çmimet e definuara në nenin 26 të Statutit të Komunës së Ulqinit ndahen në formë të Fletëfalënderimeve dhe në shuma monetare, dhe atë në lartësinë e një rroge mesatare neto e paguar në muajin i cili i paraprinë muajit në të cilin ndahet çmimi.

Neni 25

Çmimi nga neni 24 i këtij Vendimi ndahet në mbledhjen solemne me rastin e Ditës së Komunës së Ulqinit ose me rastin përvjetorëve të ndryshëm, shënimit të festave shtetërore dhe manifestimeve të tjera.

### III PROCEDURA E PARASHTRIMIT TË PROPOZIMEVE PËR NDARJEN E MIRËNJOHJEVE DHE ÇMIMEVE PUBLIKE

#### Neni 26

Procedurën e propozimit, vendimmarrjes dhe ndarjes së Mirënjohjeve dhe çmimeve publike nga neni 4, paragrafi 1, alinea b), c) dhe ç) të këtij Vendimi, e realizon Juria për ndarjen e Mirënjohjeve dhe çmimeve publike e Komunës së Ulqinit (në vijim: juria), e cila shpallë thirrjen publike për mbledhjen e propozimeve për ndarjen e Mirënjohjeve dhe çmimeve deri, më 10 tetor të vitit aktual.

#### Neni 27

Të drejtën e propozimit të kandidatëve e kanë: Kryetari i Komunës, trupat punuese të Kuvendit, këshilltari, shoqëritë ekonomike, organizatat joqeveritare, organizatat sportive dhe organizatat e tjera, bashkësitë lokale, individët dhe subjektet e tjerë, dhe atë deri, më 31 tetor të vitit aktual.

Propozimet e parashtruara jashtë kohe nuk mund të shqyrtohen.

#### Neni 28

Propozimet për ndarjen e Mirënjohjeve dhe çmimeve publike të Komunës së Ulqinit parashtrohen me shkrim.

Propozimi i shkruar për ndarjen e Mirënjohjeve dhe çmimeve publike të Komunës së Ulqinit detyrimisht duhet të përmbajë këto të dhëna: emrin dhe mbiemrin, përkatësisht emrin e parashtruesit të propozimit, vendbanimin ose selinë e parashtruesit të propozimit, emrin e mirënjohjes publike dhe çmimit dhe fushën për të cilën parashtrohet propozimi, arsyetimin e hollësishëm, përkatësisht të arriturat dhe kontributin në të cilin parashtruesi ka mirënjohje dhe çmimit publike të Komunës së Ulqinit.

#### Neni 29

Vendimin për ndarjen e Mirënjohjeve dhe çmimeve publike e nxjerr juria. Kryetarin dhe anëtarët e jurisë i emëron Kuvendi i Komunës për një periudhë prej dy vitesh dhe ata mund të riemërohen, por jo më shumë se dy herë radhazi. Propozimin për zgjedhjen e anëtarëve të jurisë Kuvendit ia paraqet Kryetari i Komunës.

#### Neni 30

Juria ka kryetarin dhe katër anëtarë. Anëtarë të jurisë emërohen personalitete të shquar publike, të kulturës, shkencorë, shëndetësorë dhe sportive. Juria në mbledhjen e parë konstituive nxjerr Rregulloren e punës. Në rastin e pushimit të mandatit një anëtar i të jurisë, anëtarit të ri mandati i zgjatën aq sa zgjatën mandati i jurisë.

#### Neni 31

Juria vendosë në mbledhje. Për rrjedhën e mbledhjes dhe votimit mbahet procesverbal. Juria sjell vendime me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve. Në rast të nevojës së verifikimit dhe shpjegimit të të dhënave nga propozimi, juria mund të kërkojë mendim nga organet kompetente shtetërore dhe organet e vetëqeverisjes lokale. Në rast të nevojës me rastin e shqyrtimit të propozimeve të parashtruara, juria mund të konsultohet me ekspertët për disa fusha.

#### Neni 32

Vendimin dhe arsyetimin për ndarjen e mirënjohjes publike, përkatësisht çmimit e komunikon në mbledhjen solemne të Kuvendit kryetari i jurisë, me rastin e dorëzimit të mirënjohjes, përkatësisht çmimit. Juria nuk do të nxjerr vendimin për ndarjen e mirënjohjeve dhe çmimeve publike nëse vlerëson që kandidati i propozuar nuk i plotëson kushtet për ndarjen e tyre. Mirënjohjen publike dhe çmimin i nënshkruan Kryetari i Komunës dhe Kryetari i Kuvendit të Komunës.

#### Neni 33

Juria ka të drejtë në kompensim për punë. Lartësinë e kompensimit nga paragrafi 1 i këtij neni e përcakton Kryetari i Komunës së Ulqinit.

### IV DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

#### Neni 34

Punët profesionale dhe administrative, si dhe evidencën për mirënjohjet dhe çmimet publike i bënë Sekretariati për administratë dhe veprimtari shoqërore.

Neni 35

Ky vendim hynë në fuqi ditën e tetë pas botimit në "Fletoren zyrtare të MT – dispozitat e komunës".

Numër: \_\_\_\_\_  
Ulqin, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2020

**KUVENDI I KOMUNËS SË ULQINIT**

**KRYETARI I KUVENDIT**  
Dr. Ilir Çapuni d.v.

## ARSYETIM

### I Baza juridike për nxjerrjen e vendimit

Bazën juridike për nxjerrjen e këtij vendimi e përmbajnë dispozitat e nenit 38, paragrafi 1 pika 2 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale ("Fletorja zyrtare e MZ", nr. 2/18 dhe 34/19) dhe nenit 27 të Statutit të Komunës së Ulqinit ("Fletorja zyrtare e MZ – dispozitat e komunës", nr. 48/19), me të cilat është parashikuar që Kuvendi nxjerr dispozita dhe akte të tjerë, si dhe që kushtet, procedura, mënyra e ndarjes së mirënjohjeve dhe çmimeve publike dhe çështe të tjera, rregullohen me vendim të posaçëm të Kuvendit të Komunës.

### II Arsyet për nxjerrjen e vendimit

Propozimi i këtij vendimi është përgatitur me qëllim të krijimit të premisave për ndarjen e mirënjohjeve dhe çmimeve të Komunës së Ulqinit që janë konstatuar me Statut të Komunës së Ulqinit, e me këtë më për së afërmi të definohen kushtet, procedura dhe mënyra e ndarjes së mirënjohjeve dhe çmimeve.

### II Shpjegimi i instituteve themelore juridike

Me këtë vendim parashikohet lënda e rregullimit të vendimit (neni 1), përcaktohen personat të cilëve u ndahet kjo mirënjohje publike (neni 3), përcaktohet lloji dhe mënyra e ndarjes së mirënjohjeve dhe çmimeve publike (neni 4 deri te neni 9), parashikon procedurën për ndarjen e mirënjohjeve publike (neni 9 deri te neni 13), formën dhe përmbajtjen e diplomës dhe mënyrën e dorëzimit (neni 9 deri te neni 13), marrjen e mirënjohjes publike të ndarë (neni 15), parashikon kushtet dhe përcakton personat të cilët mund të realizojnë të drejtën në ndarjen e mirënjohjeve dhe çmimeve publike nga neni 4, paragrafi 1, alinea b), c) dhe ç) (neni 16 deri te neni 25), si dhe procedurën e parashtrimit të propozimeve dhe ndarjes së mirënjohjeve dhe çmimeve publike (neni 26 deri te neni 33). Në dispozitat kalimtare dhe përfundimtare është de finuar organi për kryerjen e punëve profesionale dhe administrative për nevojat e jurisë (neni 34) dhe parashikon kohën e hyrjes në fuqi – vocacio legis, të këtij vendimi (neni 35).

### IV Mjetet e nevojshme për zbatimin e vendimit

Për zbatimin e këtij vendimi nevojitet të sigurohen mjete në Buxhetin e Komunës së Ulqinit.